



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 50

Datë: 18. 09. 2024, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ nr.48 dhe 49/2024

3. Raport i Këshillave të KQZ

3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Njoftim për vendimet gjyqësore për vendvotimet e rinumëruara
2. Shqyrtimi dhe miratimi i llogos së KQZ-së
3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të nominimeve të anëtareve të KQZ-së Deçan

3.2.Këshilli për Personel

1. Autorizimi i Drejtorit të SKQZ për lidhjen e marrëveshjes me palët e treta

3.3 Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Rishikimi i buxhetit për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2024-2025

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Sekretariatit për furnizim me inventar

4. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, kryetari **Radoniqi** paraqiti agjendën dhe pastaj, anëtarët e KQZ-së sugjeruan dhe plotësuan me propozimet e tyre rendin e ditës. Z. Radoniqi, e njoftoi pastaj KQZ-në për marrjen e një ftese lidhur me një konferencë njëditore në Tiranë. Ai tha se, ftesa është e adresuar për te...!

Arianit Elshani, propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e parë “Njoftim për vendimet gjyqësore për vendvotimet e rinumëruara”, ngase janë kërkuar disa plotësime në këtë dokument. Ndërsa, sa i përket pikës së tretë “Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të nominimeve të anëtareve të KQZ-së Deçan”, këtu të shtohet edhe “Kllokoti”!

Sami Kurteshi, tha se është një rekomandim nga Agjencia për Barazi Gjinore në lidhje me përbërjen e Komisioneve Komunale Zgjedhore. Dhe, ne duhet ta trajtojmë...

Gordana Llaban, propozoi që pika 2 e Këshillit për Buxhet, të hiqet nga rendi i ditës. Është bërë analiza, mirëpo duhet të shqyrtohet edhe njëherë e pastaj, të silllet në mbledhje për miratim...

Me 9 vota për, anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës.

Pastaj, me 9 vota për u miratuan edhe procesverbalet nr. 48 (me 8 vota) dhe 49/2024 (me 9 vota për), me vërejtjen e z. Kurteshi që nuk ka qenë prezentë në mbledhjen e 48. Ndërsa, znj. Gordana Llaban, pas vërejtjeve në të kaluarën, tha se tani ato janë hartuar ashtu si duhet.

3. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i llogos së KQZ-së:

Arianit Elshani, tha se KOZ-i, ka shqyrtuar rekomandimin e KOZ të ardhur edhe nga Sekretariati. Është një ndryshim i vogël. Pra, të ketë edhe ‘një përshkrim të vogël’, bëhet fjalë për versionin e tretë...

Kur e kishim simulimin, kjo u vërejtje që është e nevojshme të vendoset...

Me 9 vota për, miratohet llogoja e KQZ-së.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të nominimeve të anëtareve të KKZ-së Deçan:

Arianit Elshani, tha në pikën e dytë se KOZ-i, ka shqyrtuar edhe dy kërkesa nga subjektet politike për ti plotësuar vendet e nominimeve të KKZ-ve. Bëhet fjalë për Partinë Demokratike në Deçan, dhe AAK në Kllokot. Këto propozime, janë brenda formulës së kaluar...

Sami Kurteshi, tha në kontekst se, ka qenë kundër formulës së përbërjeve të KKZ-ve, dhe tash, është edhe një reagim nga agjencia për barazi gjinore. Vetëm dy subjekte, e kanë përmbushur kuotën gjinore siç, parashihet, dhe të tjerat nuk e kanë përmbushur...

Ne, nuk duhet të kalojmë kështu sepse na obligon edhe ligji! Së paku, 30 % do të duhej të arrihej... ! Përpjekjet i kemi bërë por, duhet arritur kjo dhe së paku 30% të arrihet. Vendimi i KQZ për përcaktimin e përbërjes së KKZ-ve, është i kundërligjshëm...

Me 9 vota për, dhe një abstenim (Sami Kurteshi), u miratua.

4. Këshilli për Personel

Autorizimi i Drejtorit të SKQZ për lidhjen e marrëveshjes me palët e treta:

Alban Krasniqi: Këshilli, e ka shqyrtuar kërkesën e drejtorit të Sekretariatit për të lidhur marrëveshje me palët e treta, me qëllim të ofrimit të shërbimit, në këtë rast si certifikues, deri sa procesi i rekrutimit për këtë pozitë të kryhet, dhe ne do ta kemi stafin e përhershëm. Kemi, një largim të zyrtarit Financiar, dhe kemi obligim të kemi certifikues sepse, kemi gjetur zyrtarin financiar. Jemi duke e parë mundësinë që ta kemi këtë zyrtar me afat të caktuar...

Me 10 vota për, autorizohet drejtori i Sekretariatit që të lidhë marrëveshje me palët e treta.

5. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Rishikimi i buxhetit për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2024-2025:

Gordana Llaban, tha se në takimin e 14 kemi shqyrtuar disa tema: E para, në kategorinë e 'investimeve kapitale' kemi shqyrtuar mundësinë për blerjen e 4 automjeteve për përdorim të KQZ-së. Për të dy vitet, 2024-25, janë në dispozicion 194, 000 euro. Si do të votojmë...? Një për një...! Apo së bashku...?

Kreshnik Radoniqi: Të gjitha bashk i votojmë...

Gordana Llaban: Pika e dytë, është shqyrtimi i buxhetit për organizimin e zgjedhjeve jashtë Kosovës. Kemi ndarë një buxhet prej 300, 000 eurove. Këto mjete, janë paraparë për dërgimin e materialit zgjedhorë jashtë, si dhe kthimin e materialit pas përfundimit të procesit të votimit. Pika e tretë, ka të bëjë me dërgimin e materialeve postare, rreth 15, 000 euro, kurse pika e katërt tretë ka të bëjë me promovimin e materialit: 68, 152 euro. Dhe pika e pestë, ka të bëjë me shqyrtimin e pilot projektit të lidhur me 'identifikimet elektronike' ku përfshihen mjete rreth 250, 000 euro.

Sami Hamiti: Te shuma e materialit promovues, kemi konstatuar që duhet të jetë "100, 000" sepse është kornizë për tri vite...!

Në fund, anëtarët e KQZ me 9 vota për, dhe 1 abstenim u miratuan rekomandimet e Këshillit të Buxhetit.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në konferencë ndërkombëtare:

Kreshnik Radoniqi, tha se ka marrë një ftesë lidhur me një konferencë njëditore në Tiranë. Ai tha se, ftesa është e adresuar për te...! Tema është: "Balanca mes rregullimit dhe vet rregullimit ligjor në fushatat zgjedhore përpara zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025". Kjo, nuk ka të bëjë me zgjedhjet në Kosovë, por atje dhe jam i ftuar unë që, të mbaj një diskutim...M duhet miratimi juaj !

Me 9 vota për miratohet, dhe një abstenim. (K. Radoniqi)

7. Të ndryshme !

Alban Krasniqi: Të premtën do mbahet dëgjimi buxhetorë, është datë orientuese...! Nuk është e konfirmuar por është mirë që kjo të konfirmohet, dhe ne të jemi në krye të detyrës. Të shohim pastaj se, kush do të jetë në mbrojtje të buxhetit të KQZ. Pra, buxhetet që i kemi të planifikuara...